



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI

Nr. 415 Prot.

Tiranë më 23.03 2020

URDHËR

Nr. 31 datë 23.03.2020

**"MBI ZHVILLIMIN E PROCESIT MESIMOR ONLINE
NE UNIVERSITETIN POLITEKNIK TE TIRANES"**

Bazuar në nenin 39 të ligjit nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 18 të Statutit të Universitetit Politeknik të Tiranës, piken 4 të urdhërit nr.156, datë 10.03.2020 të Ministrit të Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale "Për marrjen e masave të veçanta për parandalimin e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19", si dhe në kërkesat dhe porositë e përcjella përmes email-it nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë,

URDHËROJ:

1. Zhvillimin e procesit mësimor online në Universitetin Politeknik të Tiranës, mbështetur në vlerësimet e njësive kryesore të UPT, duke respektuar standardet bazë të procesit të mësimdhënies.
2. Procedurat e zhvillimit të procesit mësimor online do të realizohen sipas udhëzimeve të drejtuesve të secilës njësi kryesore të UPT, duke vlerësuar platformat më të mundshme për të operuar mbi bazë departamenti/fakulteti.
3. Njësitë kryesore, pas testimit dhe pilotimit të leksioneve online, të depozitojnë përmes komunikimit elektronik pranë Drejtorisë së Kurrikulave, deri në dt. 30.03.2020 informacionin për platformat e përdorura në lidhje me zhvillimin e procesit mësimor.
4. Ngarkohen të gjitha njësitë kryesore të UPT për zbatimin e këtij urdhëri.
5. Urdhëri ka karakter të përkohshëm dhe zbatohet vetëm në kohëzgjatjen e periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.


Rektori
2020
Prof. Dr. Andrea MALIQARI

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS

Adresa: Sheshi "Nënë Tereza", Nr.4, Tiranë,

Tel/Fax: +355 4 2227914,

web: www.upt.al